

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NË FUSHËN E POLITIKËS SË KONKURRENCËS
NDËRMJET AUTORITETIT TURK TË KONKURRENCËS DHE
AUTORITETIT SHQIPTAR TË KONKURRENCËS**

Autoriteti Turk i Konkurrencës dhe Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (referuar më poshtë si "Palët"),

Duke shprehur dëshirën për të nxitur bashkëpunimin në fushën e politikës së konkurrencës dhe zbatimin e ligjit të konkurrencës të Shteteve të Palëve,

Duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe,

Bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok,

Duke nënvizuar rolin e konkurrencës në zhvillimin efektiv të ekonomisë së tregut,

KANË RËNË DAKORD si vijon:

Neni I

Palët do të nxisin dhe forcojnë bashkëpunimin në zbatimin e ligjit të konkurrencës të Shteteve të Palëve dhe politikën e konkurrencës në përputhje me këtë Memorandum.

Neni II

Në përputhje me interesat reciproke të Palëve, bashkëpunimi do të realizohet në drejtimit kryesor si më poshtë, duke iu nënshtruar burimeve të arsyeshme në dispozicion:

- a) shkëmbimi i informacionit mbi zhvillimet ligjore;
- b) shkëmbimi i përvojave në fushën e hetimeve, në lidhje me shkeljen e rregullave të konkurrencës të Shteteve të Palëve;



c) shkëmbimin e përvojave në lidhje me marrëdhëniet midis autoriteteve të konkurrencës dhe enteve kombëtare rregullatore.

Neni III

Format kryesore të ndërveprimit ndërmjet Palëve mund të jenë si më poshtë:

a) shkëmbimi i informacionit jo-konfidencial për zhvillimet ligjore dhe rastet e konkurrencës;

b) organizimi i vizitave studimore dhe trajnimit të ekspertëve;

c) pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, simpoziume, seminare dhe aktivitete të tjera të organizuara nga Palët;

d) takime të ekspertëve ose konsultime përmes e-mail-it, ndërmjet ekspertëve të Palëve lidhur me shkëmbimin e informacionit jo-konfidencial për çështje specifike me interes të përbashkët;

e) organizimi i takimeve / vizitave të nivelit të lartë për diskutimin e perspektivave dhe drejtimeve në të cilat bashkëpunimi dypalësh do të vazhdojë;

f) shkëmbimi i dokumenteve jo-konfidencialë, studimeve, librave etj., të cilat janë botuar nga Palët.

Neni IV

Shkëmbimi i informacionit do të bëhet në gjuhën angleze, nëpërmjet postës dhe e-mail-it, përmes pikës së kontaktit të caktuar ose sipas rastit në takimet e përfaqësuesve të Palëve.

Neni V

Axhenda, vendi dhe elementët e tjerë të aktiviteteve, duke përfshirë aspektet financiare, do të vendosen individualisht nga Palët nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët.

Neni VI

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi, nëse ka, do të zgjidhen me anë të konsultimeve dhe negociatave.

Neni VII

Ky Memorandum i lidhur me qëllim rritjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve nuk përbën një marrëveshje detyruese për Shtetet e Palëve sipas



ligjit ndërkombëtar. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk duhet të interpretohet dhe zbatohet si krijimi i të drejtave ligjore ose angazhimeve për Shtetet e Palëve.

Neni VIII

Ky Memorandum do të rishikohet bashkërisht nga Palët pas konsultimeve paraprake.

Neni IX

Ky Memorandum është lidhur për një periudhë të pakufizuar kohore dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Neni X

Memorandumi mund të përfundojë nga secila Palë duke i paraqitur një njoftim me shkrim Palës tjetër.

Memorandumi do të përfundojë pas tre muajve nga data e pranimit të njoftimit me shkrim.

Neni XI

Nënshkruar në Ankara / Turqi në 18.09.2018 në dy kopje, secila në gjuhën turke, shqipe dhe angleze dhe secili tekst është autentik. Në rast të divergjencës në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të prevalojë.

Për
Autoritetin Turk të Konkurrencës



Prof. Dr. Ömer TORLAK
President

Për
Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës



Prof. Dr. Juliana LATIFI
Kryetare